



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M**

**PËR MIRATIMIN E PËRMBAJTJES SË FLETËS SË VOTIMIT PËR KANDIDATËT PËR KËSHILLIN E BASHKISË MIRDITË PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 06.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

**OBJEKT:** Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për Këshillin e Bashkisë Mirditë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

**BAZË LIGJORE:** Neni 23, pika 1 gërma a dhe neni 98, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve,

**VËREN**

Me vendimin nr. 32, datë 06.03.2015 "Për miratimin e disa rregullave për regjistrimin e koalicioneve zgjedhore në KQZ", KQZ ka përcaktuar disa rregulla për mënyrën e regjistrimit të koalicioneve zgjedhore. Në përputhje me vendimin nr. 32 të KQZ, partitë politike depozituan respektivisht në KQZ marrëveshjet e tyre dhe KQZ me vendimet përkatëse ka miratuar regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës qershor 2019 dy koalicione zgjedhore, Koalicionin Aleanca për Shqipërinë Europiane (ASE) dhe Koalicionin Shpresa për Ndryshim (SHN).



**Nr. 814 i vendimit    Data    06.06.2019 e vendimit    Ora 18.00 e Vendimit**

Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për Këshillin e Bashkisë Mirditë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Brenda afatit të përcaktuar në nenin 67, pika 1 dhe pika 2 të Kodit Zgjedhor, 10 (dhjetë) parti të Koalicionit Aleanca për Shqipërinë Europiane (ASE), 1. Partia Ardhmëria Shqiptar, 2. Partia Socialiste e Moderuar, 3. Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, 4. Partia Aleanca Arbnore Kombëtare, 5. Partia Unitetit Kombëtar, 6. Partia Aleanca Demokratike Shqiptare, 7. Partia Socialiste e Shqipërisë, 8. Partia Kristian Demokrate, 9. Partia Demokracia Sociale, 10. Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, kanë depozituar kërkesat për regjistrim listash shumemërore për kandidat për Këshillin e Bashkisë Mirditë. Gjithashtu ka depozituar lista shumemërore 1 (një) parti e cila kandidon më vete, Partia Fryma e Re Demokratike si dhe z. Fran Ndue Jushi depozitoi kërkesën për regjistrimin si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për kryetar Bashkia Mirditë.

Në përfundim të procesit të regjistrimit të listave shumemërore, KQZ në mbështetje të nenit 98, pika 3 dhe 4, Udhëzimit nr. 3, datë 04.03.2015 organizoi shortin për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për kandidatët për këshillat, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019. KQZ me vendimin nr.728, datë 30.05.2019, miratoj rezultatit e shortit duke përcaktuar numrin rendor që do të ketë cdo subjekt zgjedhore në fletën e votimit.

Renditja në fletën e votimit për kandidatët për këshillin e Bashkisë Mirditë do të bëhet sipas numrit rendor të dalë nga rezultati i shortit për partitë politike të cilat kanë depozituar lista shumemërore për këtë Bashki, sipas materilait bashkëlidhur këtij vendimi.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 23, pika 1 gërma a, nenin 97, pika 2, nenin 98, pika 3, 4 të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

#### **VENDOSI:**

1. Të miratojë përmbajtjen e fletës së votimit për kandidatët për Këshillin e Bashkisë Mirditë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas Tropojëerialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr. 814 i vendimit    Data    06.06.2019 e vendimit    Ora 18.00 e Vendimit**

Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për Këshillin e Bashkisë Mirditë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.